

# Bibël për fëmijët paraqet

## Mirupafshim Faraon



Shkruar nga: Edward Hughes  
Ilustruar nga: Janie Forest; Alastair Paterson  
Adaptuar nga: Lyn Doerksen  
Përkthyer nga: Arianit Iljazi  
Prodhuar nga: Bible for Children  
[www.M1914.org](http://www.M1914.org)

BFC  
PO Box 3  
Winnipeg, MB R3C 2G1  
Canada

©2021 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,  
nëse nuk do ta shitni.

1



Faraoni ishte i  
zemëruar! Perëndia  
e kishte urdhëruar  
atë nëpërmjet  
Moisiut ti linte  
skllëverit Izraelitë  
të iknin nga Egjipti.


2



"Vërnini të punojnë më rëndë", i urdhëroi Faraoni rojet e skllëvërve. Tani gjërat ishin edhe më keq për Izraelitët.

3

"Mblidhni vetë kashtën. Ne nuk do t'ju japim më. Por bëni të njëjtin numër tullash."



4



Nëpunënesit fshikullonin ata skllëvër që nuk mblidhnin dot mjaftueshëm kashtë për të prodhuar aq tulla sa u

kërkohej.

5



Njerëzit fajësuan Moisiun dhe Aronin për telashet e tyre. Moisiu gjeti një vend për tu lutur.

6



"O PERËNDI", thirri ai, "Ti nuk e ke shpenguar popullin Tënd, fare". "Unë jam PERËNDIA dhe Unë do t'ju shpengoj",

u përgjigj Perëndia.


7



Pastaj, Perëndia dërgoi Moisiun dhe Aronin përsëri tek Faraoni. Kur sundimtari i fuqishëm u kërkoi shërbëtorëve të Perëndisë një shenjë prej Tij,

shkopi i Aronit u kthye në një gjarpër rrëshqitës.


8



"Thërrisni magjistarët e mi", ulëriti Faraoni. Kur magjistarët Egjiptianë hodhën shkopat e tyre, secili nga to u bë një gjarpër. Por shkopi i Aronit i gëlltiti të tjerët. Megjithatë Faraoni refuzoi ta lërë popullin të shkojë.


9

Mëngjesin tjetër, Moisiu dhe Aroni takuan Faraonin buzë lumit. Kur Aroni zgjati shkopin e tij, Perëndia e ktheu ujin në gjak. Peshqit vdiqën! Njerëzit nuk mund ta pinin më.




10

Por Faraoni e ngurtësoi zemrën e tij. Ai nuk po i linte Izraelitët të largoheshin nga Egjipti.



11


Përsëri, Moisiu i tha Faraonit që ti lërë njerëzit e Perëndisë të shkojnë. Faraoni nuk pranoi përsëri.



Perëndia dërgoi një plagë tjetër. I gjithë Egjipti u mbush me bretkoca. Çdo shtëpi, çdo dhomë, madje edhe sobat e gatimit ishin plot e përplot me bretkoca!

12

"Lutuni për mua, që Perëndia të largojë bretkocat", u lut Faraoni. "Dhe unë do ti lë njerëzit tuaj të shkojnë". Por kur bretkocat u larguan, Faraoni ndryshoi mendje. Ai nuk donte ti linte të lirë skllëverit.




13

Pastaj Perëndia dërgoi miliarda insekte të vogla të quajtur mushkonja. Çdo njeri dhe kafshë filloi të kruhet nga pickimet e tyre, por Faraoni përsëri nuk donte të dorëzohej përpara Perëndisë.




14



Pas kësaj Perëndia dërgoi miza, koloni të panumërta mizash. Perëndia dërgoi sëmundje për të vrarë Egjiptasit.



15



Perëndia dërgoi ulçera. Njerëzit vuajtën tmerrësisht. Megjithatë Faraoni vazhdonte ti rezistonte Perëndisë.



16



Pas plagës së ulçerave, Perëndia dërgoi hordhi të tëra karaklecash. Karkalecat hëngrën çdo bimë të gjelbër në vend.


17



Pastaj Perëndia dërgoi tre ditë të një errësire të plotë. Por Faraoni kokëfortë nuk donte ti linte të lirë Izraelitët.

18

"Unë do të dërgoj edhe një plagë të fundit", paralajmëroi Perëndia. "Rreth mesit të natës, të gjithë të parëlindurit e njerëzve dhe të kafshëve, do të vdesin". Perëndia u tha Izraelitëve se të parëlindurit e tyre do të shpëtoheshin, nëse ata do ta vendosnin gjakun e qengjave në shtalkat e dyerve të tyre.



19



Në mesnatë, një britmë e madhe u dëgjua mbi Egjipt. Vdekja kishte goditur. Së paku një njeri kishte vdekur në çdo shtëpi.

20



"Dilni prej këndej",  
iu lut Faraoni  
Mosiut. "Shkoni,  
shërbejini  
Perëndisë".

21



Me shpejtësi,  
njerëzit e Perëndisë  
marshuan përtej  
kufirit të  
Egjiptit.

22



Perëndia i tha Mosiut të  
kujtonte Natën e Pashkës,  
sepse Engjëlli i Perëndisë kishte kaluar  
përmbi shtëpitë e Izraelitëve dhe kishte  
goditur Faraonin dhe njerëzit e tij.

23




Pas 430 vitesh në Egjipt,  
njerëzit e Perëndisë ishin tani të lirë.  
Perëndia i drejtoi ata me një kollonë reje gjatë  
ditës, dhe një kollonë zjarri gjatë natës.

24



Por Faraoni nuk  
kishte mbaruar me  
Izraelitët. Përsëri,  
ai e harroi Perëndinë.  
Përsëri ai ndryshoi  
mendje. Duke  
mbledhur ushtrinë  
e tij, ai shkoi në  
ndjekje të  
skllëvërve.

25



"Perëndia do të luftojë për ju", tha Mosiu.  
Mosiu shkoi përpara drejt bregut të detit  
dhe shtriu krahun e tij.

26





Një mrekulli e paparë ndodhi. Perëndia hapi një shteg në mes të ujit. Njerëzit kaluan të sigurtë.

27

Pastaj, ushtria e Faraonit kalëroi në Detin e Kuq. "Tani do ti kapim", menduan ushtarët. Por Perëndia mbylli ujrat. Ushtria e fuqishme e Faraonit u përpi në mes të detit. Tani Faraoni e mori vesh që Perëndia i Izraelit është Perëndi përmbi gjithçka.



28

### Mirupafshim Faraon


Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Eksodi 4-15

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."  
Psalmet 119:130

29



11



60

30

Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkatet. Dënimi për mëkatet është vdekja, por Perëndia ju do juve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu: Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem, eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo, të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

31